


RAPORTI II

Versioni përfundimtarë

Transparenca në Bashkinë Shkodër



Shoqëria "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a.

Dhjetor 2016

1.Hyrje

Publikimi i këtij raporti niset nga ndjeshmëria e lartë publike për të bërë transparente zbatimin e ligjshmërisë në shoqërinë aksionere “**KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA**”. Ndonëse ka patur kërkesa të shumta për të bërë transparencën e kësaj shoqërie duhet theksuar se drejtuesit vendore nuk e kanë realizuar asnjëherë një proces të tillë. Prandaj nisma e ndërmarrë nga një organizatë e shoqërisë civile, për të hedhur dritë mbi transparencën, ndërtimin funksionimin dhe veprimtarinë e shoqërisë “Vllaznia” sh.a. nëpërmjet prezantimit të fakteve dhe argumentave ligjore, merr një rëndësi të veçantë.

Ky raport synon që të sjell në vëmendjen e drejtuesve të shoqërisë aksionere “**KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA**” Sh.a., të zgjedhurve vendore, drejtuesve të administratës vendore në Shkodër si dhe të gjithë mekanizmit shtetërorë të tilla si Kontrolli i Lartë i Shtetit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministrisë së Pushtetit Lokale, Prefekturës Shkodër etj që të ndërmarrin të gjitha hapat e duhur ligjorë për të bërë të mundur zbatimin e ligjshmërisë dhe zhvillimin e veprimtarisë së kësaj shoqërie në mënyrë sa më transparente të mundshme dhe brenda kornizave ligjore.

Gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë parasysh parimet e funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë tregtare të shoqërive publike të përcaktuara sipas ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*, ligji Nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*, ligji Nr. 139/2015, *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, Ligji nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti bazohen në parimet dhe detyrimet e sanksionuara nga ligjet e përshkruara mësipër prandaj besojmë që do të shërbejnë si një udhëzues i rëndësishëm për të bërë të mundur përmirësimin e punës së kësaj shoqërie nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së saj. Nga ana tjetër raporti synon ti bëjë të njohur publikut të gjithë informacionin e nevojshëm mbi mënyrën e funksionimit dhe ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë

Ky raport u përgatit me iniciativën e shoqatës “Intelektualët e rinj, Shpresë”, në kuadër të projektit “Bëhu aktiv, ndërto të ardhmen!” me mbështetjen financiare të Olof Palme International Center në Shqipëri përmes financimit të Qeverisë Suedeze, nga Prof.Asoc.Dr.Hemion Braho, pedagog, pranë Universitetit Evropian të Tiranës, Dr.Mirgen Prence, pedagog pranë Universitetit Evropian të Tiranës dhe Dr.Blendi Dibra, ekspert në fushën e të Drejtës Publike. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e Olof Palme International Center dhe Qeverisë Suedeze.

Metodologjia

Hartimi i këtij raporti është bërë i mundur nëpërmjet komunikimeve zyrtare me Bashkinë Shkodër, kontakteve të drejpërdrejta me drejtues dhe të zgjedhur vendorë, monitorimit të faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër www.bashkiashkoder.gov.al/ si dhe faqes zyrtare të shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a. www.vllaznia.al

Gjatë periudhës Maj-Shtator 2016 gjithsej dërguar 7 kërkesa për informim nga të cilat vetëm në një rast përgjigja është kthyer brenda afatit ligjor. Në katër raste kërkesat tona për informim janë ripërsëritur dhe në kushtet kur është refuzuar dhënia e informacionit është bërë ankim sipas ligjit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Në një rast Komisionieri për të Drejtën e Informimit ka aplikuar sanksionin me gjobë ndaj Bashkisë Shkodër i parashikuar nga ligji Nr.119/2014, “*Për të drejtën e informimit*” për rastet kur autoritetet publike refuzojnë dhënien e informacionit.

Informacioni i grumbulluar i është nënshtruar ballafaqimit me dispozitat ligjore duke bërë më të lehtë arritjen e përfundimeve dhe rekomandimeve për përmirësimin e punës në drejtim të zbatimit të ligjmërisë në ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë aksionere “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a.

Raporti është fokusuar kryesisht në zbatimin e ligjit Nr.119/2014, “*Për të drejtën e informimit*”, dhe të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*, duke analizuar ndërtimin, funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit tregtarë të shoqërisë në bazë të informacioneve të grumbullura nëpërmjet dokumentave zyrtare.

1. Transparenca sipas ligjit për të drejtën e informimit

1.1. Sipas ligjit Nr.119/2014, “***Për të drejtën e informimit***” synohet të rregullohet e drejta e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga “autoritetet publike”¹. Në germën b të nenit 2 të këtij ligji përcaktohet se “autoritete publike” janë shoqëritë tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve. Prandaj edhe shoqëria aksionere “**KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA**” sh.a ku Bashkia Shkoder zotëron 100% të aksioneve është subjekt i këtij ligji.

Fig.1. Përgjigje e Bashkisë Shkodër nr.11702, datë 20/9/2016 ndaj kërkesave për informacion


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Nr. 11702 Prot Shkoder, me 20/9 /2016

Drejtuar: Intelktualet e rinj shprese (I.R.SH)

Lënda: Kthim përgjigjet.

Ne përgjigjet të kërkesës nr.12 datë 6 maj 2016 e protokolluar me nr.5272 datë 9.5.2016, kërkesës nr. 17 datë 28 qershor 2016 e protokolluar me nr.8275 datë 1.7.2016, kërkesës nr. 18 datë 28 qershor 2016 e protokolluar me nr.8276 datë 1.7.2016, kërkesës nr. 19 datë 28 qershor 2016 e protokolluar me nr.8271 datë 1.7.2016, kërkesës nr. 20 datë 28 qershor 2016 e protokolluar me nr.8274 datë 1.7.2016, kërkesës nr. 21 datë 28 qershor 2016 e protokolluar me nr.8270 datë 1.7.2016, kërkesës nr. 23 datë 16 Gusht 2016 e protokolluar me nr.10236 datë 19.8.2016, kërkesës nr. 24 datë 16 Gusht 2016 e protokolluar me nr.10239 datë 19.8.2016, kërkesës nr.25 datë 16 gusht 2016 e protokolluar me nr.10237 datë 19.8.2016, kërkesës nr.26 datë 16 gusht 2016 e protokolluar me nr.10238 datë 19.8.2016, në të cilat kërkoni informacion për:

Koment: Siç u përmend edhe mësipër gjatë hartimit të këtij raporti janë ndeshur vështirësi në grumbullimin e informacionit zyrtarë. Mungesa e respektimit të detyrimeve ligjore nga ana e drejtuesve lokalë përbën një problematikë më vehte në përgjithësi. Synimi ka qënë që raporti të hartohet në formën e një bashkpunimi për të kontribuar në korrigjimin e atyre gabimeve që mund të konstatoheshin nga analizimi i të dhënave. Duke parë një lloj mefshtësie nga ana e drejtuesve vendorë ku informacioni i kërkuar nga katër shkresat e dërguara mungonte vendosëm ti ridërgonim këto kërkesa me shpresën që informacioni i kërkuar do të dërgohej. Në kushtet kur edhe kërkesat e ripërsëritura nuk morën asnjë përgjigje atëherë ju drejtuam Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Menjëherë pas ankimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u bë e mundur të merret informacioni i kërkuar!

¹ Shih nenin 1 ligjit Nr. 119/2014, “***Për të drejtën e informimit***”

Duke qënë se shoqëria aksionere “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a. është një shoqëri e cila ka organet e veta drejtuese të gjitha përgjigjet e ardhura nuk mbajnë firmën dhe vulën e autoriteteve drejtuese të shoqërisë por të Kryetares së Bashkisë ose thënë ndryshe përfaqësueses së aksionerit të vetëm të shoqërisë. Duke qënë se shoqëria ka fituar personalitetin e saj juridik është e domosdoshme që të ngrihet mekanizmi i duhur për të dhënë informacionin që kërkohet nga publiku brenda afateve ligjore nga personat përgjegjës të cilët punojnë për shoqërinë!

1.2. Sipas pikës 5 të nenit 2 të ligjit Nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” përcaktohet se “Program transparence” është:

“tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik, sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 7 të këtij ligji.”

Fig.2 Faqja zyrtare e shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a.



Koment: Nga informacionet e grumbulluara Shoqëria “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a. si një shoqëri publike me kapital 100% të Bashkisë Shkodër e rregjistruar si person juridik më vehte është e detyruar të zbatojë dispozitat e nenit 4 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” duke miratuar programin e transparencës si dhe duke e publikuar atë në faqen zyrtare të shoqërisë www.vllaznia.al nuk e ka publikuar atë në faqen zyrtare të shoqërisë.

1.3. Në zbatim të gërmës a, pika 1 e nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” shoqëria ka publikuar strukturën organizative, funksioneve dhe detyrave e cila përbëhet nga:

- a) Administratori
- b) Këshilli Mbikqyrës
- c) Drejtori Sportiv
- d) Zëdhënësi
- e) Financieri

Koment: Në website jepet informacion mbi adresën e shoqërisë si dhe tregohet mënyra sesi mund të merret informacion në zbatim të gërmës c, neni 7 i ligjit Nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” ndonëse nuk ka një informacion mbi të dhënat e kordinatorit për të drejtën e informimit në kundërshtim me gërmën ç të nenit 7 të po këtij ligji.

1.4 Në gërmën d neni 7 i ligjit Nr.119/2014, “**Për të drejtën e informimit**” përcaktohet se autoriteti publik duhet të jap të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime.

Koment: *Si një shoqëri publike “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a. duhet të publikoj informacion në lidhje me strukturat e pagave, detyrat e funksionarëve të lartë të autoritetit publik si dhe procedurat që ato ndjekin për të marrë vendime. Ky informacion aktualisht nuk ekziston!*

Statuti nuk ka parashikuar rolin e Drejtorit Sportiv, të zëdhënësit të shtypit si dhe të financierit. Nga informacionet e grumbulluara nuk ka të dhëna në lidhje me funksionet dhe detyrat që kryejnë si dhe mënyra dhe procedura e ndjekur për përzgjedhjen e titullarëve që mbajnë këto funksione. Prandaj është e nevojshme të kryhen modifikimet e duhura për ti përshtatur me keto funksione. Po ashtu është e nevojshme miratimi i një rregulloreje të brendshme ku të përcaktohen kriteret dhe procedurat e punësimit, si dhe indikatorët e vlerësimit të performancës në punë të punonjësve.

1.5. Sipas gërmës dh të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, “**Për të drejtën e informimit**” autoriteti publik është i detyruar të publikoj:

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

Koment: *Duke qënë se shoqëria nuk ka ngritur një sistem monitorimi dhe në kushtet kur bilanci i shoqërisë rezulton me humbje duhet në mënyrë të menjëhershme të ngrihet një sistem monitorimi i cili vlerëson rreziqet që i kanosen shoqërisë.*

Nga monitorimi i kryer rezulton se nuk janë përmbushur detyrimet e ngarkuara nga ligji Nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” në gërmën e) të nenit 7 ku duhet që të publikohen të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.

Nga monitorimi nuk rezulton të jetë përmbushur asnjë detyrim ligjor i përcaktuar në gërmën ë) të nenit 7 të ligjit Nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” ku nuk ka asnjë të dhënë mbi listën e kontratave të lidhura, shumat e kontraktuara, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, zbatimin dhe monitorimin e kontratave etj.

Shoqëria “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a nuk rezulton të ketë krijuar rregjistrin e kërkesave në zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar në pikën 8 të ligjit Nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”

2.Funksionimi sipas **ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"**

Këshilli Bashkiak me vendimin nr.9 dt.26.08.2011 të Këshillit Bashkiak Shkodër ka vendosur miratimin e krijimit të shoqërisë aksionere “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA”. Transferimi i Klubit të futbollit Vllaznia në shoqëri aksionere bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1718, datë 24.12.2008, ku në pikën 1 të tij është përcaktuar se:

“Klubet sportive, që do të transferohen në shoqëri aksionare, do të funksionojnë në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Pra baza ligjore për funksionimin dhe ushtrimin e veprimtarisë tregtare të shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a është **ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"**

2.1.Në këtë ligj e drejta për informim sanksionohet në nenin 15 të **tij**. Sipas këtij neni ligji detyron personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë të vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji. Ky detyrim mund të përmbushet edhe duke e vendosur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare dhe duke informuar për këtë personat, të cilët e bëjnë kërkesën. Në të kundërt, këto dokumente duhet të vihen në dispozicion, për shqyrtim, pranë zyrës qendrore të shoqërisë tregtare. Po ashtu sipas pikes 2 të nenit 106 të **ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"** përcaktohet se:

“Nëse shoqëria krijon një faqe të saj në internet, të dhënat, të cilat regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, publikohen në këtë faqe dhe u vihen në dispozicion personave të interesuar”

Fig.3 Faqja zyrtare e shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a.



Koment: Gjatë aktiviteteve të monitorimit nuk rezulton që këto informacione të jenë publikuar në faqen e internetit të shoqërisë www.vllaznia.al Nga ana tjetër kërkesat për informim të dërguara për hartimin e këtij raporti ka patur një hezitim për dhënien e informacionit të kërkuar dhe vetëm me ndërhyrjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit është bërë e mundur që të merret ky informacion.

Shoqërisë i duhet që të krijoj një mekanizëm informimi ku çdo palë e interesuar mund ta marrë informacionin në mënyrë sa më të lehtë të mundur duke e bërë aktivitetin e shoqërisë sa më transparent. Faqja e internetit e shoqërisë duhet të japë informacion në lidhje me aktivitetin ekonomik të shoqërisë duke publikuar të gjitha dokumentat të cilat janë detyrim ligjorë për tu dhënë pa kërkesë.

2..2 Në nenin 19 *ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"* përcaktohet krijimi i Këshillit të Punëmarrësve. Të drejtat e këtij Këshilli janë sanksionuar në nenin 20 të *ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"* ndër të cilat mund të përmendim:

1. Këshilli i punëmarrësve monitoron zbatimin e ligjeve, të kontratave kolektive dhe dispozitave të statutit dhe përfaqëson interesat e punëmarrësve të shoqërisë. Këshilli merr pjesë në vendimmarrjen për shfrytëzimin e fondeve të posaçme dhe të aktiveve të tjera të shoqërisë, të parashikuara në kontratat kolektive dhe në statut, si dhe për shpërndarjen e pjesës së fitimeve, që asambleja e përgjithshme vendos t'ia shpërndajë punëmarrësve.
2. Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë e mban këshillin e punëmarrësve të informuar për veprimtaritë dhe ecurinë e shoqërisë tregtare e në mënyrë të veçantë për efektet e politikave të shoqërisë për kushtet e punës, pagat, sigurinë në punë, ndarjen e mundshme të fitimeve, ndryshimin e statusit, sistemin e pensioneve të shoqërisë, rristurimin dhe pjesëmarrjen e shoqërisë në shoqëri të tjera. Përfaqësuesi ligjor, me kërkesën e këshillit të punëmarrësve, paraqet gjendjen e llogarive, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e këshillit mbikëqyrës apo të ekspertëve kontabël të autorizuar. Ky detyrim mund të përmbushet edhe duke e shpallur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare dhe duke e informuar për këtë këshillin e punëmarrësve. Në të kundërt, mund të kërket që përgjigjet të jenë me shkrim, duke përdorur edhe mjete të komunikimit elektronik.
3. Këshilli i punëmarrësve, gjithashtu, mund të informojë veten drejtpërdrejt për performancën e shoqërisë tregtare dhe të këqyrë librat e dokumentet e shoqërisë, duke u dhënë mendime dhe sugjerime organeve drejtuese për çështjet e përmendura në pikën 2 të këtij neni. Përfaqësuesi ligjor e informon këshillin e punëmarrësve për arsyet e mospranimit të mendimeve dhe të sugjerimeve të këtij këshilli.
4. Statuti nuk mund ta pengojë apo kufizojë ushtrimin e të drejtave të përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe këshillit të punëmarrësve për një sistem ekuivalent informimi. Nëse përfaqësuesi ligjor nuk pranon të japë informacionet, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, këshilli i punëmarrësve, brenda 2 javëve pas refuzimit, mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të marrë një vendim detyrues për informimin.
5. Këshilli i punëmarrësve i raporton asamblesë së punëmarrësve të shoqërisë për veprimtaritë e veta të paktën dy herë në vit ose sa herë e kërkon shumica e punëmarrësve.
6. Kostot e zgjedhjes dhe të funksionimit të këshillit mbulohen nga shoqëria tregtare.

Koment: Rezulton që shoqëria “Vllaznia” Sh.a ka lidhur kontrata me mbi 26 punmarrës. Në statut në kundërshtim me ligjin nuk është parashikuar krijimi i “Këshillit të punmarrësve”. Rekomandohet që të bëhen modifikimet e duhura në statut dhe të parashikohet krijimi i Këshillit të punmarrësve. Ky Këshill do të ishte një instrument i duhur ligjor si pjesë e sistemit të monitorimit të veprimtarisë së shoqërisë

2.3 Në pikën 2 të nenit 134 të **ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"** përcaktohet se:

“Shoqëritë aksionare, në raportin e ecures së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore duhet të përshijnë një dokument shpjegues, ku trajtohen e shpjegohen parimet e rregullat e miradministrit dhe të drejtimit të brendshëm të shoqërisë dhe praktikat, që ndiqen prej saj, në zbatim të dispozitave të këtij ligji. Deklarata e miradministrit të shoqërisë duhet të përmbajë një profil të administratorëve dhe të anëtarëve të këshillave, si dhe të shpjegojë elementet e faktet, për të cilat këta individë janë të kualifikuar për të kryer detyrat, që i janë caktuar nga shoqëria. Kjo deklaratë vendoset edhe në faqen e internetit të shoqërisë.”

Koment: Nga monitorimi i aktivitetit të shoqërisë tregtare Vllaznia Sh.a ka rezultuar se kjo dispozitë ligjore nuk është zbatuar në asnjë rast nga shoqëria. Prandaj është domosdoshmëri që shoqëria të hartoj dhe të publikoj:

- 1) Parimet e rregullat e miradministrit dhe të drejtimit të brendshëm të shoqërisë si dhe praktikat që ndiqen prej saj
- 2) Deklaratën e miradministrit të shoqërisë
- 3) Profilin e administratorëve dhe anëtarëve të këshillave, ku të shpjegohen elementet e faktet, për të cilat këta individë janë të kualifikuar për të kryer detyrat, që i janë caktuar nga shoqëria.
- 4) Deklaratën e miradministrit të shoqërisë.

2.4 Në nenin 167 të **ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"** parashikohet përbërja, të drejtat e detyrimit e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët ndër të cilat mund të përmendim:

1. Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës:

- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
- c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecures së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;

g) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;

Koment: Nga monitorimi i zhvilluar gjatë periudhës së përgatitjes së këtij raporti rezulton një pasivitet i veprimtarisë së Këshillit Mbikqyrës sidomos nga periudha Janar-Tetor 2016 figuron vetëm një vendim i marrë ai me datë 08.01.2016 nr 1. Rekomandohet që Këshilli Mbikqyrës të luaj një rol aktiv në përmbushje të detyrimeve ligjore të përshkruara mësipër duke garantuar respektimin e ligjit dhe standarteve të kontabilitetit nga shoqëria. Bilanci vjetorë i shoqërisë që nga krijimi i saj rezulton të jetë negative dhe nuk rezulton asnjë vendim i Këshillit Mbikqyrës për analizimin e riskut të shoqërisë dhe thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme. Rekomandohet që Këshilli Mbikqyrës të thërras asamblen e shoqërisë për analizimin e situatës financiare si dhe përcaktimin e ecurisë së mëtejshme të saj.

2.5. Sipas nenit 167, pika 2 e ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" shprehet se: "Veprimet e administratorëve u nënshtrohen miratimit nga këshilli mbikqyrës vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht në statut"

Koment: Nga analizimi i informacionit të marrë nuk rezulton një rol aktiv i administratorit në administrimin e shoqërisë. Që nga themelimi i shoqërisë dhe deri në periudhën aktuale të përgatitjes së këtij raporti përveç vitit të parë nuk rezulton që administrator ti ketë kërkuar Këshillit Mbikqyrës apo Asamblesë analizimin e situatës financiare të shoqërisë. Kjo rrjedh edhe ngaqë nuk ka një ndarje të qartë të detyrave dhe funksioneve ndërmjet administratorit, Këshillit Mbikqyrës, përfaqesuesit të aksionerit të vetëm si dhe funksionarëve të tjerë të administratës së Bashkisë Shkodër të cilët punojnë për llogari të shoqërisë. Rezulton e domosdoshme që kompetencat të jenë të saktësuara sa më saktë në statut si dhe në rregullore të brendshme të shoqërisë për të bërë të mundur ushtrimin e funksioneve sipas përgjegjësisë të ngarkuara. Këshilli Mbikqyrës duhet të përcaktojë saktë procedurat për përzgjedhjen e administratorëve, profilin që ato duhet të kenë, indikatorët e performancës të cilët do shërbejnë për vlerësimin e tyre. Nga monitorimi i zhvilluar ka rezultuar se një praktikë e tillë nuk ekziston. Rezulton se levizjet e administratorëve janë kryer pa një arsyetim ligjorë të performancës së tyre. Po ashtu në asnjë rast nuk është e qartë procedura që është ndjekur për emërimin e administratorëve të shoqërisë.

3. Statuti dhe veprimtaria e shoqërisë

3.1 Në statutin e shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a. në nenin 7 të saj është përcaktuar se:

“Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 (dy million) leke”

Koment: Ne ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në nenin 107 në pikën 2 të tij është përcaktuar se:

“Shoqëria aksionare me ofertë publike nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 10 000 000 lekë.”

3.2 Në nenin 3 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" është përcaktuar se qëllimi i shoqërive tregtare është arritja e objektivave ekonomike duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj.

Koment: Në nenin 4 të statutit, objekti i shoqërisë është krejtësisht i paqartë dhe nuk i përgjigjet në mënyrën e duhur qëllimit të krijimit të një shoqërie tregtare për arritjen e objektivave ekonomike. Pra thënë më ndryshe nuk arrihet të kuptohet se çfarë objektivash ekonomik kërkon të arrij shoqëria tregtare “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a. Konkretisht në objektin e saj thuhet se:

“Futja në tregun e lojtarëve sipas nevojave të ekipit”

Shoqëria futbollistike duhet të përcaktoj më saktësisht në objektin e saj karakterin e theksuar ekonomik dhe tregtarë. Për shembull qëllimi i saj mund të jetë investime në infrastrukturën sportive, me qëllim rritjen e cilësisë sportive për të synuar shitblerjen e futbollistëve, biletave, tregun e aksioneve, shitblerjen e materialeve dhe produkteve sportive si dhe atyre në funksion të zhvillimit të sportit, nëpërmjet nxitjes së një marketingu profesional dhe zhvillimit të aktiviteteve promocionale etj.

3.3 Në statut në kundërshtim me nenin 134 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nuk është parashikuar adresa e shoqërisë në internet si dhe adresa email.

3.4 Ne Kapitullin e II statuti i shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a. paraqet mangësi të theksuara qoftë në konceptimin e tij qoftë në përmbushjen e detyrimeve ligjore të cilat rrjedhin nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Konkretisht ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ka parashikuar kriteret mbi aksionet nga nenet 116-133. Ndërsa në statut nuk parashikohet mënyra e fitimit dhe e kalimit të aksioneve, llojet dhe kategoritë e aksioneve, marrëdhëniet ligjore të shoqërisë dhe aksioneve etj. Këto të dhëna

përbëjnë thelbin e shoqërisë aksionere dhe mungesa e një informacioni të tillë vendos në dyshim edhe ekzistencën e shoqërisë si shoqëri aksionere!

3.5 Në Kapitullin e III të statutit të shoqërisë Vllaznia sh.a. prezantohen organet e shoqërisë. Ajo që vihet re në ndryshim me statutet tip për shoqëritë aksionare statuti është i ndërtuar në një mënyrë të paqartë duke mos treguar qartë organet e shoqërisë, mënyrën e krijimit të tyre, funksionimit si dhe të drejtat që ato kanë.

3.6 Në seksionin ku flitet në lidhje me funksionimin e Asamblesë nuk është parashikuar rregjistri i vendimeve ku rregjistrimi i vendimeve të asamblesë është i detyrueshëm pasi përndryshe vendimet rezultojnë të jenë absolutisht të pavlefshme

3.7 Në seksionin 2 ku flitet në lidhje me funksionimin e Këshillit Mbikqyrës në nenin 22 të statutit të tij parashikohet hartimi i një rregulloreje për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës.

Nëpërmjet shkresës **Nr.11702.Prot**, datë **20/09/2016** të përfaqësuesit të aksionerit të vetëm Bashkisë Shkodër sipas kërkesës sonë na është dërguar **“Kopje e Rregullores për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës”**

Dokumenti i dërguar është një dokument që mban datën **21 Tetorë 2011** i miratuar nga Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori **“Rregullore e brendshme e KF.”Vllaznia**” sh.a ku përfshihen rregulla sjellje vetëm për futbollistët!

Prandaj rezulton se nuk ekziston një **“Rregullore për Procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës”** siç kërkohet nga statuti dhe ligji nr.9901, datë 14.4.2008 **“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”**

3.8 Në nenin 22 të statutit përcaktohet se: “Vendimet e Keshillit Mbikqyrës mund të merren sipas përcaktimeve të statutit apo rregulloreve të këshillit duke shprehur votën me shkresë, tel apo mjete tjera të komunikimit elektronik që bëjnë të mundur identifikimin e anëtarit”

Një formë e tillë votimi e cila gjindet edhe e zbatuar në praktikë është në kundërshtim të plotë me nenin 45 pika 4 të Kushtetutës si dhe legjislacionin në fuqi ku garantohet liria dhe fshehtësia e votës. Një formë e tillë votimi krijon kushtet për të patur një këshillë jo funksional dhe i ndërtuar jo në principe demokratike.

3.9 Në nenin 26 të Shoqërisë parashikohet që Këshilli mbikqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblenë e Përgjithshme kur “humbjet në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit”

Koment: Ndonëse shoqëria bilancin e ka patur me humbje sistematike asnjëherë nuk ka ndodhur përmbushja e një përgjegjësie të tillë nga Këshilli Mbikqyrës!

3.10 Nga neni 28 deri në nenin 32 përshkruhen kompetencat e administratorit. Në nenin 30 të statutit rezulton se administratorët janë të detyruar: “të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë”.

Koment: Nga Komunikimet me Bashkinë rezulton se një detyrim i tillë nuk është përmbushur dhe se sistemi i monitorimit nuk ekziston!

Fig 4: Përgjigje e Bashkisë Shkodër Nr.prot 11702 datë 20/09/2016

5. Informacion mbi sistemin e monitorimit të njoftimit të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë Vllaznia sh.a të krijuar sipas detyrimit ligjor nga Administratori.
- 5.1 Nuk ekziston një dokument i cili paraqet kërkesat e sipërpërmendura.

3.11 Në nenin 30 statuti ngarkon me përgjegjësi administratorin që të informoj kryetarin e këshillit mbikqyrës kur *“humbjet ne një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit”*

Koment: Ndonëse shoqëria bilancin e ka patur me humbje sistematike asnjëherë nuk ka ndodhur përmbushja e një përgjegjësie të tillë nga administratorët!

3.12 Neni 41 i statutit parashikon se: *“Nëpunësit, të zgjedhurit nga Organet drejtuese të shoqërisë, e personave që punojnë për llogari të saj, mbajnë përgjegjësi penale e civile sipas ligjit përkatës kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara e i shkaktojnë humbje shoqërisë”*

Koment: Sipas të gjitha informacioneve të marra, gjetjeve të raportit të auditit shoqëria funksion jashtë kornizës ligjore dhe çdo vit financiarë mbyllet me humbje. Nga ana e Bashkisë nuk rezulton të jetë marrë qoftë edhe një masë administrative ndaj personave përgjegjës të kësaj situate!

3.13 Në statut nuk është parashikuar ndarja e fitimeve çka e ka paragjykuar në njëfarë mënyre që në fillimin e krijimit të shoqërisë faktin se ajo do të rezultojë me humbje.

4.Veprimtaria e shoqërisë

Këshilli Bashkiak me vendimin nr.9 dt.26.08.2011 të Këshillit Bashkiak Shkodër ka vendosur miratimin e krijimit të shoqërisë aksionere “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA”. Transferimi i Klubit të futbollit Vllaznia në shoqëri aksionere bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1718, datë 24.12.2008 ku në pikën 2 të tij përcaktohet se:

“Procedura e transformimit të tyre fillon me daljen e urdhrat të titullarit të institucionit, në varësi administrative të të cilit është klubi sportiv.”

Ndërsa në pikën 4 të këtij Vendimi përcaktohet se:

“Përcaktimi i kapitalit të këtyre shoqërive bëhet nga një komision i ngritur pranë çdo klubi, me urdhrat të titullarit të tij”

Koment: Në bazë të informacionit të marrë nga Bashkia Shkodër me 20 Maj 2016, nr.5275/1.prot, konstatohet se në zbatim të V.K.M Nr.1718, datë 24.12.2008, **është përmbushur detyrimi i përcaktuar në pikën 2,** ku me Vendimin nr.9 datë 26.08.2011 të Këshillit Bashkiak Shkodër është miratuar transferimi i Klubit të Futbollit Vllaznia në shoqëri aksionere.

Nga informacionet e marra nga Bashkia Shkodër rezulton se nuk është përmbushur detyrimi i përcaktuar në pikën 4, të VKM Nr.1718, datë 24.12.2008 **ku duhej që të ngrihej një komision për përcaktimin e kapitalit të shoqërisë.**


Po ashtu nga dokumentacioni i dhënë në formë shkresore nga Bashkia Shkodër rezultojnë dy vendime të vlerësuara nga formulimi juridik janë të pavlefshme dhe përkatësisht Vendimi nr.1, datë 11.10.2011 dhe Vendimi Nr.2, datë 20.10.2011 **ku në këto vendime nuk cilësohet fakti që Bashkia Shkodër është ortak e vetme.**

Po ashtu rezultojnë dy vendime të Asamblesë së Përgjithshme njeri me nr.3 dhe datë 31 Korrik 2012 dhe tjetri me nr.4 datë 3 Maj 2012 të cilat rezultojnë me **një gabim administrativ në përcaktimin e numrave rendore.**

4.1. Sipas shkresës Nr.7897 Prot datë 23/06/2016 dërguar nga Përfaqësuesja e ortakut të vetëm “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a, rezulton se Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë Bashkisë Shkodër në muajin Tetorë 2015 ka kryer një auditim në shoqërinë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a për periudhën 2011-2015 ndërkohë që nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk ka patur asnjë auditim gjatë kësaj periudhe. Nëpërmjet kësaj shkrese është refuzuar kërkesa për të marrë një kopje të plotë të raportit të auditimit me arsyen se:

“Për shkak të pengesave të pikës b, neni 17 i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nga ana e jonë është e pamundur të vëmë në dispozicion kopjen e raportit të auditimit. Bashkëlidhur, ju dërgojmë gjetjet dhe rekomandimet e Auditimit të Brendshëm të cilat do të publikohen dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër”

Fig.5. Përgjigje e Bashkisë Shkodër nr.7897, datë 23/6/2016



Koment: Ligji nr.119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", në gjurmën b, neni 17 i saj ka përcaktuar se:

"E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: b) sekretin tregtar;"

Në gjurmën dh, neni 7 ligji nr.119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", ka përcaktuar se:

"Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;"

Koment: Refuzimi për të dhënë kopjen e raportit të auditimit nuk është i bazuar në ligj duke qënë se shoqëria "*KLUBI FUTBOLLIT VLLAZNIA*" sh.a. financohet nga taksapaguesit shkodranë. Deri tani kjo shoqëri rezulton me bilanc negativ dhe bërja publike e raportit të auditimit është instrumenti i parë për të ndërtuar transparencën, besueshmërinë dhe përgjegjshmërinë ndaj qytetarëve.

4.2. Më tej në shkresën 7897 datë 23/06/2016 dërguar nga Përfaqësuesja e ortakut të vetëm "*KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA*", thuhet:

"Bashkelidhur, ju dërgojm gjetjet dhe rekomandimet e Auditimit të Brendshëm, të cilat do të publikohen dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër."

Koment: Dokumenti i dërguar “Gjetjet dhe rekomandimet e Auditimit të Brendshëm”, dhe më vonë edhe i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë në internet nuk përmbush kriteret themelore të një dokumenti zyrtarë. Konkretisht ky dokument i printuar në një letër pa logon e institucionit që përdoret zakonisht nga Bashkia Shkodër nuk përmban datën kur është përpiluar, nuk përmban asnjë numër protokolli, nuk përmban emrat e funksionarit/funksionarëve të cilët e kanë përpiluar një dokument të tillë, firmat e tyre, vulën e institucionit etj.

Rekomandojmë: Bashkinë Shkodër që të marrë të gjitha masat e duhura për publikimin e dokumentave zyrtare, të akteve të cilat prodhohen gjatë veprimtarisë së saj administrative sipas standarteve dhe formateve të duhura ligjore.

4.3.Sipas shkresës 11584/1 datë 30/09/2016 dërguar nga Përfaqësuesja e ortakut të vetëm “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a, pyetjes sesa prej rekomandimeve të lëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë zbatuar, është shprehur se:

”Lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve nga Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a. nuk ka akoma një dokument final”

Fig.6. Përgjigje e Bashkisë Shkodër nr.11584/1, datë 30/9/2016

REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel+35522400150

Nr. 11584/1 Prot Shkodër, më 30/9 / 2016

Lënda: Kthim Përgjigje
Drejtuar: Presidentit të Intelektualët e Rinj, Shpresë (I.R.SH) .

Në përgjigje të shkresës Tuaj “Kërkesë për Informim” me Nr.32, administruar në Bashkinë Shkodër me datë 19.09.2016, bazuar në ligjin nr. 119/2014” Për të drejtën e Informimit” dhe në Informacionin e marrë pranë Njesisë së Auditit të Bashkisë Shkodër, Ju Informojme si vijon :

Në përgjigje të pyetjes së parë,
Rekomandimet e lëna nga Njësia e Auditit të Brendshëm për zbatim nga Klubi i Futbollit “Vllaznia”, sh.a , janë të natyrave të ndryshme dhe afateve të ndryshme, të cilat kërkojnë periudha të ndryshme të realizimit të tyre.
Lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve nga Klubi i Futbollit “ Vllaznia ” sh.a, nuk ka akoma një dokument final .

Koment: Kërkesa për informacion nuk ka marrë një përgjigje të drejpërdrejt duke lënë hapsirë për interpretime të ndryshme. Gjithsesi nga informacionet e grumbulluara nuk rezulton që të jetë marrë në konsideratë ndonjë prej rekomandimeve të lëna nga njësia e Auditimit të Brendshëm duke qënë se:


- 1) Statuti vazhdon të mbetet i pandryshuar
- 2) Nga Janari-Shtatorë 2016 ka vetëm një vendim të Këshillit Mbikqyrës ndonëse statuti e përcakton se duhet të mblidhet të paktën dy herë në vit.

Prandaj rekomandohet që të nisë menjëherë zbatimi i rekomandimeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm duke informuar hapat konkret që lidhen me zbatimin e tyre

4.4 NËPËRMJET KËRKESËS SONË PËR INFORMACION I ËSHTË KËRKUAR BASHKISË SHKODËR INFORMACION SIPAS DETYRIMIT LIGJOR NËSE E KA DËRGUAR KOPJEN E RAPORTIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM TEK KONTROLLI I LARTË I SHTETIT. SIPAS SHKRESËS 11584/1 DATË 30/09/2016 DËRGUAR NGA PËRFAQËSUESJA E AKSIONERIT TË VETËM “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” SH.A INFORMOHEMI SE:

“Lidhur me Klubin e Futbollit “Vllaznia” sh.a Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk ka bërë ndonjë kërkesë bashkëpunimi për shkëmbim informacioni apo raportit të auditimit”

Fig 7 Përgjigje e Bashkisë Nr.Prot 11584/1 datë 30/09/2016



Koment: Ligji nr.114/2015, “***Për auditimin e Brendshëm në sektorin publik***” në nenin 25 të tij i detyron autoritetet publike të shkëmbejnë informacion me Kontrollin e Lartë të Shtetit për shmangien e mbivendosjeve në lidhje me planet e auditimit si dhe raportet e auditimit duke përcaktuar se:

“1. Struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm dhe njësitë e auditimit të brendshëm bashkëpunojnë me Kontrollin e Lartë të Shtetit bazuar në parimet e komunikimit të vazhdueshëm, angazhimit, mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë.

2. Mbi bazën e këtyre parimeve, fushat kryesore të bashkëpunimit janë:

a) shkëmbimi i planit të konsoliduar të auditimit, me synim shmangien e mbivendosjeve;

b) shkëmbimi i informacionit dhe i raporteve të auditimit;

c) zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe trajnimi i përbashkët.

Pra rezulton se ligji i detyron autoritetet publike të shkëmbejnë informacion në lidhje me planet e auditimit për të shmangur mbivendosjet, si dhe shkëmbimin e raporteve të auditimit.

Rekomandohet: -Ti dërgohet Kontrollit të Lartë të Shtetit menjëherë kopja e plotë e Raportit të Auditimit të shoqërisë “KLUBI FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a. si dhe të publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë në internet. (duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, fshirjen e emrave që mund të jenë përmendur në raport)


-Të krijohet një bashkëpunim më i ngushtë me strukturat e specializuara të auditimit të fondeve publike të tilla si Kontrolli i Lartë i Shtetit por edhe me kompani të tjera jashtë autoritetit publik të cilat kanë përvojë në fushën e auditimit në mënyrë që të bëhet e mundur rritja e transparencës dhe e besueshmërisë tek publiku.

4.5 Nëpërmjet shkresës Nr.5275/1.Prot, datë 20/05/2016 të përfaqësuesit të ortakut të vetëm Bashkisë Shkodër sipas kërkesës sonë janë dërguar vendimet e asamblesë të shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a

Koment: Nga analizimi i këtyre vendimeve ajo që bie në sy është se në total janë 23 vendime të asamblesë nga të cilat 16 prej tyre vendosin për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, 6 vendime lidhen me miratimin e ndryshimeve në Këshillin Mbikqyrës dhe vetëm Vendimi nr.3 datë 31.7.2012 i asamblesë lidhet me miratimin e raportit të shoqërisë. Pra në asnjë prej vendimeve tjera nuk rezulton që të ketë miratuar ndonjë plan masash apo politika të caktuara të cilat shërbejnë për evitimin e humbjeve duke krijuar kushtet që shoqëria të dal me bilanc pozitiv!

4.6 Nëpërmjet shkresës Nr.11702.Prot, datë 20/09/2016 të përfaqësuesit të ortakut të vetëm Bashkisë Shkodër sipas kërkesës sonë janë dërguar pasqyrat financiare të shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a për vitin 2014 dhe 2015. Vlen të theksohet **shënimi ekspertës kontabël në pasqyrat financiare të periudhës 01/01/2014 – 31/12/2014 përgatitur me datë 12/03/2015 thekson se:**


Fig 8 Raporti i ekspertës kontabël për vitin 2014



“Shoqëria ka patur një humbje neto prej 55.636.630 lek gjatë vitit të mbyllur 31 Dhjetorë 2014 dhe deri në këtë datë detyrimet e shoqërisë kanë tejkaluar totalin e aktiveve të saj për Shumën 16.486.210 lek. Gjithashtu shoqëria ka rezultuar me humbje neto 42.836.952 lek gjatë vitit të mbyllur 31 Dhjetor 2013 dhe deri në këtë datë detyrimet e shoqërisë kanë tejkaluar totalin e aktiveve të saj për Shumën 4.849.580 lek. Kapitali i shoqërisë janë negative dhe kapitali neto është zvogëluar me 11.636.630 lek në krahasim me periudhën paraardhëse 2013. Këto kushte tregojnë për ekzistencën e një pasigurie materiale e cila mund të hedh dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi”

Po ashtu në pasqyrat financiare të periudhës 01/01/2015 – 31/12/2015 përgatitur me datë 12/02/2016, Eksperti kontabel thekson se:

Fig 9 Raporti i ekspertës kontabël për vitin 2015



“Shoqëria ka patur një humbje neto prej 72.597.202 lekë gjatë vitit të mbyllur 31 Dhjetorë 2015 dhe deri në këtë datë detyrimet e shoqërisë kanë tejkaluar totalin e aktiveve të saj për Shumën 31.261.412 lek. Gjithashtu shoqëria ka rezultuar me humbje neto 55.636.630 lek gjatë vitit të mbyllur 31 Dhjetor 2014 dhe deri në këtë datë detyrimet e shoqërisë kanë tejkaluar totalin e aktiveve të saj për Shumën 16.486.210 lek. Kapitalet e shoqërisë janë negative dhe kapitali neto është zvogëluar me 14.775.202 lek në krahasim me periudhën paraardhëse 2014. Këto kushte tregojnë për ekzistencën e një pasigurie materiale e cila mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi”

Koment: Siç rezulton nga raporti i ekspertës kontabël ekzistojnë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a për të vazhduar në vijimësi. Ky koment vjen në mënyrë të përsëritur si në raportin financiarë të vitit 2014 ashtu edhe në atë 2015. Nga dokumentat zyrtare që disponojmë nuk ka patur asnjë masë të marrë si nga Administratori si nga Këshilli Mbikqyrës e po ashtu edhe nga aksioneri i vetëm Bashkia Shkodër.

4.7 Nëpërmjet shkresës Nr.11702.Prot, datë 20/09/2016 të përfaqësuesit të aksionerit të vetëm Bashkisë Shkodër sipas kërkesës sonë jemi informuar se:

“Deklarata e miradministrimit të shoqërisë e cila duhet të përmbajë një profil të administratorit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës sipas përcaktimeve të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nuk ekziston”,

4.8 Nëpërmjet shkresës Nr.11702.Prot, datë 20/09/2016 të përfaqësuesit të aksionerit të vetëm Bashkisë Shkodër sipas kërkesës sonë jemi informuar se:

Fig 10: Përgjigje e Bashkisë Shkodër Nr.prot 11702 datë 20/09/2016

5. Informacion mbi sistemin e monitorimit të njoftimit të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë Vllaznia sh.a të krijuar sipas detyrimit ligjor nga Administratori.
- 5.1 Nuk ekziston një dokument i cili paraqet kërkesat e sipërpërmendura.

“Sistemi i monitorimit të njoftimit të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë” sipas përcaktimeve të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nuk ekziston”

5.Konkluzione dhe rekomandime:

Siç rezultoi mësipër nëpërmjet fakteve dhe argumentave ligjore shoqëria “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a me kapital 100% të Bashkisë Shkodër si aksioneri i vetëm mbart probleme të shumta si në aspektin ligjor, organizativ dhe funksional ashtu edhe në drejtim të transparencës së veprimtarisë së saj ndaj taksapaguesve shkodranë. Ligji Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ngarkon autoritetet lokale që të bëjnë transparente veprimtarinë e tyre ndaj publikut ku në pikën 1 të nenit 15 ka përcaktuar se:

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.”

Nga analiza e bërë gjatë periudhës së monitorimit të aktivitetit të shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a me kapital 100% të Bashkisë Shkodër rezultoi se niveli i transparencës nuk i përmbush kërkesat e duhura ligjore

Përballë kësaj situate rezulton e nevojshme që të bëhet një analizë më e hollësishme ligjore dhe e dokumentave financiare për të bërë të mundur auditimin e shoqërisë në mënyrë profesionale si dhe të merren vendimet e duhura ligjore.

Në situatën aktuale kur shoqëria prej 5 vitesh rezulton me humbje të cilat rëndojnë buxhetin e Bashkisë Shkodër shoqëria sipas përcaktimeve ligjore janë plotësuar kushtet për të kaluar në situatën e falimentit. Ligji nr.9920 dt.19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” në nenin 104, pika 1 gërma c) ngarkon Administratën Tatimore që të kërkojnë në gjykatë fillimin e procedurës së falimentit për tatimpaguesin shoqëri tregtare nëse ka rezultuar me humbje të kapitaleve të veta të paktën 3 vite rresht.

Përsa mësipër duke qënë se tashmë shoqëria gjindet përballë kushteve ligjore të falimentit sugjerojm:

- 1) Aksionerit të vetëm Bashkisë Shkodër të analizoj dhe të vlerësoj saktë në përputhje me ligjin kushtet për ekzistencën e shoqërisë aksionere “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” duke vendosur në mënyrë të menjëhershme dhe sa më të shpejtë shpalljen e falimentimit të shoqërisë ose shitjen e aksioneve të shoqërisë.
- 2) Në rast të një vendimi për shitjen e aksioneve lind domosdoshmëri realizimi i ndryshimeve në statut ku të përcaktohet saktë mënyra e shitjes së aksioneve si dhe të miratohen brenda një afati sa më të shpejtë, me qëllim ruajtjen e ekzistencës së shoqërisë, të gjitha procedurat për nxjerrjen në shitje të aksioneve.
- 3) Të gjitha vendimet për të ardhmen e shoqërisë KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a të bëhen transparente për publikun duke respektuar të gjitha kërkesat ligjore të përcaktuara në *ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”* si dhe ligjin Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.
- 4) Kontrollit të Lartë të Shtetit: të përfshij në planet e tij, Auditimin e shoqërisë “KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a me kapital 100% të Bashkisë Shkodër mbi përdorimin, administrimin e fondeve publike gjatë gjithë periudhës së aktivitetit të saj.
- 5) Aksionerit të vetëm të shoqërisë Bashkia Shkodër të publikojë të gjitha masat që janë marrë dhe do të merren në zbatimin e gjetjeve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Shënim: Ky raport përpara prezantimit të tij me datën **16 Nëntor 2016** i është dërguar Bashkisë Shkodër duke i kërkuar dhënien e komenteve në lidhje me gjetjet e raportit dhe duke caktuar si afat perfundimtarë ligjor për dërgimin e komenteve datën **5 Dhjetor 2016**. Nga ana e Bashkisë Shkodër nuk ka patur asnjë përgjigje dhe nuk është dërguar asnjë koment çka tregon se gjetjet e raportit të mbështetura me referenca ligjore dhe fakte kanë qene me vend dhe janë pranuar të gjitha nga Bashkia Shkodër!



"INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE" (I.R.SH)
"YOUNG INTELLECTUALS, HOPE" ("YIH")
L: "QEMAL STAFI", RR: "DAUT BORIÇI", NR= 874,
SHKODER, ALBANIA
TEL/FAX: +355 222 48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com
Date 14 Nentore 2016


Drejtuar: **Znj.Voltana Ademi,**
Kryetare e Bashkise Shkoder

E nderuar znj.Kryetare,

Ju lutem gjeni bashkangjitur kopjen e Raportit te Dyte mbi Transparencen ne Bashkine e Shkodres ku ne fokus eshte transparenca ne shoqerine aksionere "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a.. Ne do te kerkonin vleresimin dhe komentet Tuaja si perfaqesuese e Bashkise Shkoder ne lidhje me gjetjet e Raportit duke na informuar ne menyre konkrete per ato gjetje te cilat jeni dakort dhe per ato gjetje te cilat nuk qendrojne duke na dhene edhe kopje te dokumentave ne menyre qe ti bashkangjesim per tu publikuar ne raportin final.

Ne do t'ju luteshim qe komentet Tuaja ti sillni brenda 20 diteve nga marrja e ketij njoftimi ose jo me vone se data 5 Dhjetore 2016.

Nderkohe Ju rikujtojme edhe njehere se organizata e jone mbetet e perkushtuar per bashkpunimin me Bashkine Shkoder duke Ju ofruar te gjitha asistencen e nevojshme per te vazhduar kete iniciative e cila qe ne fillimet e saj ka dhene rezultatet e para pozitive!

Singerisht

Samir Beqiraga
President i IRSH

